



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 39

Prishtinë, më 22.03.2016 në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-2

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRITET EVROPIAN

Në mbledhje morën pjesë: Teuta Sahatqija, Luljeta Gutaj-Veselaj, Bislim Zogaj, Arben Gashi, Vjosa Osmani dhe Ilir Deda.

Munguan: Xhavit Haliti, Slobodan Petroviç, Kujtim Paçaku, Valdete Bajrami dhe Time Kadrijaj.

Nga Staf i mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

E ftuar: znj. Hykmete Bajrami, ministre e Tregtisë dhe Industrisë.

Mbledhjen e kryesoi znj. Teuta Sahatqija, kryetare e Komisionit.

Në mbledhje u propozua ky :

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 1.3.2016;**
- 3. Raportim i znj. Hykmete Bajrami, ministre e Tregtisë dhe Industrisë;**
- 4. Shqyrtimi i Raportit të grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-140 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale;**
- 5. Të ndryshme.**

Teuta Sahatqija, kryetare e Komisionit, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë, hapi mbledhjen.

Fillimisht, i uroi mirëseardhje ministres Bajrami dhe tha se arsyeja e ftesës është që të diskutojmë për MSA-në, dhe siç e dimë, pjesa më madhe e MSA-së ka të bëjë me zhvillimin ekonomik, me tarifa e që në fakt është në kompetencë të ministrisë suaj. Në vazhdim, njoftoi se në gazetën zyrtare të BE-së është publikuar MSA dhe tani është dokument zyrtar. Para pak kohësh, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi edhe Planin kombëtar për zbatimin e MSA-së, andaj kërkoi nga ministrja që ta njoftojë Komisionin lidhur me përgatitjet e bëra nga ministria lidhur me të dhe pastaj të parashtrohen pyetje nga deputetët.

Hykmete Bajrami, ministre e Tregtisë dhe Industrisë, falënderoi për ftesën, por kërkoi falje për mosdërgimin e raportit me kohë. Sipas saj, raporti është përpiluar në bazë të kapitujve, të cilët definohen në Planin e veprimit të MTI-së, e që janë kapitulli 1, 3, 6,7, 20, 28 dhe 30 të Acquis, ku parashihen obligimet e MTI-së.

Sa i përket përafrimit të legjislacionit me BE-në, tha se shumica e punëve janë punë që kanë filluar dhe janë në vazhdim e sipër.

MTI-ja, pas aprovimit të Planit kombëtar për zbatimin e MSA-së, ka filluar me organizimin e takimeve informuese me bizneset, ku i informojmë bizneset me elementet kryesore të MSA-së dhe kriteret e standardet të cilat kërkohen nga tregu i BE-së, në mënyrë që produktet të mund të plasohen në këto tregje. MTI do të vazhdojë informimin e bizneseve edhe përmes nëngrupeve që ekzistojnë për konsultime me bizneset, si dhe ka caktuar një orar për informimin e bizneseve për MSA-në dhe kjo mbahet çdo të premte, prej orës 14.00, deri në orën 15.00.

Kapitulli 1. Lëvizja e lirë e mallrave

MTI është duke e hartuar koncept-dokumentin për ndryshimin dhe plotësimi i Ligjit për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit, si dhe të akteve nënligjore, të cilat dalin nga ky ligj për fushat specifike të produkteve (pajisjet elektrike, lodrat, pajisjet me gaz, liftet dhe komponentët e sigurisë). Ndryshimi i Ligjit në fjalë, ka për qëllim harmonizimin me Rregulloren 765/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 9 korrik 2008, që ka të bëjë me përcaktimin e kërkuar për akreditim dhe mbikëqyrje të tregut për vendosjen e produkteve në treg dhe Vendimit 768/ 2008/ EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 9 korrik 2008 për një kuadër të përbashkët për marketingun e produkteve. Qëllimi i këtij harmonizimi është për të zhvilluar dhe për të rritur konkurrencën Kosovare edhe më tutje në tregun e vendeve të rajonit dhe atë evropian, përmirësimin e sigurisë së produkteve, ruajtjen e shëndetit dhe sigurinë në punë, mbrojtjen e mjedisit, natyrës dhe mbrojtjen e konsumatorit, si dhe zhvillimin e legjislacionit dhe infrastrukturës teknike, e cila do të lejojë lëvizjen e lirë të mallrave në tregun e BE-së.

Është hartuar koncept-dokumenti për ndryshimin e Ligjit për produkte të ndërtimit, i cili aktualisht është në konsultim publik. Pas miratimit të tij, do të fillojë puna për finalizimin e draftit të parë të Ligjit për produkte të ndërtimit, i cili transponon Rregulloren 305/2011/EU (CPR-Rregullorja për Produktet e Ndërtimit).

Sa i përket **metrologjisë**, Udhëzimi administrativ për instrumentet matëse, është finalizuar dhe pritet të aprovohet dhe do të hyjë në fuqi në muajin prill të këtij viti. Brenda këtij viti planifikohet amendamenti i Ligjit të metrologjisë.

Jemi duke punuar edhe në përmirësimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë në Metrologji. Kjo ishte sfidë e ngritur në Raportin e Progresit 2015, dhe në këtë drejtim, në muajin janar është emëruar zyrtari përgjegjës, si dhe drejtuesit e katër laboratorëve (atij të masës, vëllimit, termometrisë dhe forcës).

Po ashtu, stafi i Agjencisë së Metrologjisë së Kosovës (AMK), është duke u trajnuar vazhdimisht, në të gjithë segmentet e metrologjisë. Trajnimet, kryesisht po mbështeten nga projekti i Lëvizjes së Lirë të Mallrave (IPA- Instrumenti i Asistencës të Para-anëtarësimit). Për më shumë në lidhje me ngritjen e kapaciteteve teknike të laboratorëve të metrologjisë në plan për

këtë vit është akreditimi i laboratorëve të masës, vëllimit dhe termometrisë. Emërimi i drejtuesve të laboratorëve, akreditimi, si dhe trajnimi i stafit janë veprime që përmirësojnë funksionimin e laboratorëve të metrologjisë dhe janë në funksion të adresimit të sfidës së gjetur në Raportin e Progresit 2016, ku theksohet se laboratorët e metrologjisë duhet të përmirësojnë funksionimin për t'i plotësuar standardet relevante. Sfiduese mbetet çështja e rritjes së numrit të zyrtarëve, sfidë kjo e gjetur për disa vite me radhë, në Raport të Progresit, ekspertët e metrologjisë nga BE-ja, rekomandojnë minimum dyfishimin e numrit të zyrtarëve.

Lidhur me **akreditimin**, tha se ka filluar amendamentimi i Ligjit të akreditimit dhe është themeluar grupi punues përkatës dhe ligji planifikohet të dërgohet në Qeveri për miratim gjatë pjesës së parë të këtij viti.

Në plan është të vazhdohet me rritjen e numrit të trupave të vlerësimit të konformitetit (TVK), rritja e numrit të trupave bëhet në bazë të kërkesave të tregut dhe trupat autorizohen, duke e zbatuar legjislacionin në fuqi. Trupat e vlerësimit të konformitetit janë promotorë i cilësisë së produkteve, prandaj është me shumë rëndësi mbulimi sa më i madh i tregut

Lidhur me **standardizimin**, tha se MTI-ja ka filluar me amendamentimin e Ligjit të standardizimit, dhe rrjedhimisht, është themeluar grupi punues, ndërsa ky ligj planifikohet të miratohet në shtator 2016.

Sa i përket adoptimit të standardeve evropiane dhe ndërkombëtare, deri më tani, kemi adoptuar 8,646 standarde. Gjatë këtij vitit në plan është adoptimi edhe i 1,500 standardeve të tjera.

Shitja “Online” e standardeve, e gjetur si sfidë në Raportin e Progresit 2015, është e planifikuar të mundësohet në vitin 2017, pasi që të zhvillohet sistemi elektronik që do të mundësojë një shërbim të tillë. Sa i përket anëtarësimit të Agjencisë Kosovare të Standardizimit (ASK), në organizatat relevante ndërkombëtare të standardizimit, mbetet sfidues fakti që nuk jemi anëtar të OKB-së .

Tek **Inspektorati i Tregut**, tha se kemi filluar me amendamentimin e Ligjit të Inspektoratit, ku përveç tjerash, do të definohet edhe çështja e organizimit funksional. Pra, veprimi në fjalë është hap i rëndësishëm në kuadër të procesit të reformimit të sistemit të përgjithshëm të inspektimeve dhe fuqizimit të mbikëqyrjes së tregut.

Në funksion të adresimit të sfidës së Raportit të Progresit, në lidhje me implementimin e Rregullores së BE-së për shkëmbim të të dhënave për produkte të rrezikshme, është në finalizim databaza e shkëmbimit të të dhënave për produktet e rrezikshme. Databaza është konform databazës evropiane RAPEX (Sistem për Alarmim të Shpejtë për Produktet e Rrezikshme) dhe planifikohet të jetë funksionale në tetor 2016. Planifikohet të vazhdohet me përmirësimin e efikasitetit të inspektimeve të tregut.

Në vazhdim, tha se te **Mbrojtja e tregut**, MTI, në Mars 2016, ka hartuar Udhëzimin Administrativ për Masat anti-damping dhe Masat kundër-balancuese, i cili do të raportohet si e arritur në takimin e radhës të DPSA-së, në Bruksel, në muajin prill, pasi që ishte zotim nga takimi i kaluar i DPSA-së 2015.

Po ashtu, është realizuar ueb-platforma elektronike “Raporto barrierat”, e cila është funksionale, e realizuar nga MTI-ja, në bashkëpunim me projektin e BE-së për mbështetjen e mëtutjeshme të politikave tregtare (IPA). Platforma elektronike, tashmë ua mundëson bizneseve kosovare të kenë shumë më të lehtë adresimin e barrierave tregtare gjatë eksportit, importit apo kalimit transit të mallrave të tyre

Ndërsa, sa i përket adresimit të sfidës së Raportit të Progresit 2015, për ngritje të vetëdijes së bizneseve për infrastrukturë të cilësisë. MTI-ja do të vazhdojë me aktivitete të përbashkëta për tri dikasteret e lartpërmendura. Pra, do të vazhdohet edhe këtë vit me punëtori me biznese, si dhe në takimet e planifikuara të sektorëve industrialë, ndërsa fokus të veçantë do të ketë çështja e komponentëve të infrastrukturës së cilësisë.

Aktet tjera ligjore, ato primare dhe sekondare, do të hartohen sipas afatit të paraparë në planin legjislativ. Strategjia për infrastrukturë të cilësisë do të jetë pjesë e Strategjisë së Zhvillimit të

Sektorit Privat 2016-2021 dhe tani jemi në fazën e themelimit të grupeve punuese për hartimin e kësaj strategjie.

Në mbështetje të realizimit të aktiviteteve të lartpërmendura, përveç donatorëve tjerë, është edhe projekti i Bashkimit Evropian, që mbështet përmirësimin e Lëvizjes së Lirë të Mallrave (IPA-Instrumenti Asistencës të Para-anëtarësimit). Ndërsa në planet e projekteve të IPA-s II, është planifikuar të realizohet mbështetja e bizneseve për certifikimin e produkteve/shërbimeve me certifikata kredibile ndërkombëtare dhe kjo mbështetje planifikohet t'u jepet bizneseve në formën e kuponëve (voucherave). Projektet e IPA-s II, planifikohen të fillojnë implementimin në fillim të vitit 2017. Projektet, përveç certifikimit, planifikohen të vazhdojnë mbështetjen për përafrim të legjislacionit, trajnim të stafit, anëtarësim në organizatat relevante dhe ngritje të kapaciteteve.

Kapitulli 3. Liria e ofrimit të shërbimeve

Inputi për themelimin e kompanive, përkatësisht pjesën e MTI-së gjendet në kapitullin 6 të këtij raporti, e vlen të theksohet që bizneset e huaja me legjislacionin aktual trajtohen njëjtë me bizneset vendore, sa i përket regjistrimit të kompanisë/biznesit.

Ndërsa, sa i përket të dhënave të tregtisë, databazat e shërbimeve janë themeluar dhe tani janë funksionale edhe në sistemin qeveritar, ku të gjitha ministritë kanë qasje.

Ekzistojnë 6 databaza, të cilat i menaxhon Departamenti i Tregtisë i MTI-së, ku Kosova është duke negociuar shërbimet me vendet e CEFTA-s.

Sa i përket adresimit të sfidës së Raportit të Progresit, përkatësisht transpozimit të Direktivës Evropiane të Shërbimeve, në muajin nëntor 2015, është aprovuar nga Qeveria koncept-dokumenti, i cili i paraprin ligjit të shërbimeve. Ndërsa, në muajin shkurt 2016, është themeluar grupi punues për hartimin e Ligjit për shërbime. Grupi është duke mbajtur takime të rregullta dhe drafti i parë i ligjit planifikohet të përfundojë në muajin qershor 2016. Qëllimi i këtij ligji është reduktimi/eliminimi i barrierave administrative dhe ligjore për ofruesit vendorë dhe të huaj të shërbimeve. Ligji për shërbimet do të jetë ligj horizontal, që do të afektojë ligjet tjera relevante, të cilat rregullojnë çështjen ofrimit të shërbimeve.

Tek Kapitulli 6. E drejta e kompanisë

Ligji i ri për shoqëri tregtare është duke u hartuar, pra është ligji që transponon direktivat evropiane të përmendura në plan. Ligji planifikohet të miratohet deri në fund të vitit 2016. Do të rishikohet edhe pjesa e qeverisjes së korporatave, duke iu referuar, po ashtu legjislacionit relevant evropian. Po ashtu, ky ligj do të përfshijë edhe reformat e ndërmarra nga MTI-ja dhe ministritë e tjera relevante, në kuadër të Reformës së raportit të të bërit biznes, ku synohet që me ndryshimet e ndërmarra, të përmirësohet edhe renditjen e Kosovës në këtë raport kredibil ndërkombëtar.

Në plan për vitin 2017, është krijimi i mundësisë së regjistrimit elektronik të bizneseve, e adresuar si sfida në Raportin e Progresit

Kapitulli 7. E drejta e pronësisë intelektuale

Në fushën e pronësisë industriale, jemi të gatshëm që t'i plotësojmë kriteret në fushën legjislative. Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar 4 ligje bazë për pronësinë industriale. Në të njëjtën kohë, si ministre e Tregtisë dhe Industrisë, kam nxjerrë vendimin për planin legjislativ të miratimit të akteve nënligjore, me të cilin të gjitha udhëzimet administrative që dalin nga ligjet e miratuara, do të miratohen më së largu deri në fund të muajit korrik 2016.

Agjencia për Pronësi Industriale, në fillim të vitit, ka pasur në 'backlog' mbi 24 mijë lëndë të grumbulluara nga vitet e mëparshme, prej të cilave, me ndihmën edhe të projektit të BE-së "Lëvizja e lirë e mallrave", është arritur të përfundojnë rreth 20 mijë lëndë.

Kapitulli 20. Ndërmarrjet dhe politikat industriale

Qasja e vështirë në financa për bizneset, është sfidë e gjetur në Raport të Progresit, prandaj për të adresuar këtë sfidë, është aprovuar Ligji për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, dhe është në proces e sipër formimi i bordit drejtues. Objektiv i këtij ligji është krijimi i bazës ligjore të mirëfilltë, që të ndihmojë në zgjidhjen e problemit të qasjes së kufizuar në financa, si pengesë për zhvillimin e NMV-ve, punësimin, si dhe zhvillimin ekonomik në Kosovë. Sa i përket Ligjit për kamatëvonesat në transaksionet tregtare (Direktiva 2011/7/BE), është formuar grupi punues dhe ka filluar punën për hartimin e këtij ligji.

Na plan është amendamenti i Ligjit për zonat ekonomike. Tani është duke u hartuar koncept-dokumenti relevant. Po ashtu, është duke u amendamentuar Ligji për Turizëm, i cili planifikohet të finalizohet në muajin tetor 2016. Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik të Kosovës (KKZHE) është ri-funksionalizuar dhe ka mbajtur katër takime gjatë vitit 2015 dhe një në vitin 2016, si dhe ka formuar katër grupe punuese.

Kapitulli 28. Mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit

Njoftoi se është në proces amendamenti i Ligjit të konsumatorit, koncept-dokumenti është aprovuar dhe ligji planifikohet të miratohet në tetor 2016. Është hartuar dhe në janar të këtij viti, ku është miratuar Programi për Mbrojtjen e Konsumatorit 2016-2020, i cili do të jetë udhërrëfyes i zhvillimit të këtij dikasteri. Planifikohet, po ashtu, të vazhdohet me trajnimin e stafit, duke u fokusuar në teknikat e komunikimit dhe metodat e adresimit të ankesave, si dhe mbrojtjen e konsumatorit në fushën e ushqimit.

Kapitulli 30. Marrëdhëniet me jashtë

Sfidë e identifikuar në Raport të Progresit tha është çështja e anëtarësimit në Organizatën Botërore të Tregtisë. Prandaj, me qëllim të aplikimit për anëtarësim në Organizatën Botërore të Tregtisë, është përgatitur drafti i parë i Memorandumit mbi Regjimin e Tregtisë së Jashtme, drafti është përgatitur nga MTI në vitin 2015 dhe pritet të finalizohet gjatë këtij viti, me mbështetje nga UNDP (Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara). Memorandumi është hapi i parë drejt anëtarësimit në OBT dhe si i tillë pasqyron politikat tregtare dhe ekonomike të vendit aplikues. Ndërsa, vendimi për aplikim do të merret pas konsultimeve me Qeverisë dhe shteteve partnere, që e mbështesin Kosovën për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare. Në vitin e kaluar, MTI ka zhvilluar takime me Drejtorinë për Zgjerim dhe disa prej misionëve permanente në OBT, me qëllim të lobimit me rastin e aplikimit të Kosovës në këtë organizatë.

Kryetarja e Komisionit, falënderoi ministren për raportim të detajuar dhe tha se shumë nga pyetjet të cilat desha t'i shtroj, veç u dhanë përgjigjet.

Ajo tha se është tepër e rëndësishme që MSA-ja hap mundësinë që bizneset tona të jenë më konkurrense dhe të depërtojnë në tregun 300 milionësh dhe bizneset janë duke u përgatitur të hyjnë në tregun e madh. Ishte lajm i mirë Fondi Kombëtar për Garanci, duke pasur parasysh që një prej pengesave më të mëdha të bizneseve tona, janë kamatat e larta dhe rreziqet që bankat i përdorin si investime të rrezikshme, në mënyrë që t'i ngritin kamatat. Mendoj që përmes këtij fondi kombëtar, biznesi ynë do të marrë frymë më lirshëm dhe do të ketë mundësi që mjetet e tyre financiare ti drejtojnë në ngritjen e kapaciteteve të tyre.

Në vazhdim, pyeti ministren për kapacitetet administrative, sa është kjo administratë e përgatitur, që të jetë përballë kërkesave që do t'i shtrohen bizneseve dhe ekonomisë.

Në anën tjetër, IPA janë fonde të mëdha që mund të ndihmojnë në ngritjen e zhvillimit ekonomik, por gjithashtu nga vendet përreth, të cilat i kanë shfrytëzuar, mirëpo e dimë që këto fonde e kapacitetet absorbuese të atyre vendeve, nuk kanë qenë në nivel që t'i përdorin. Na tregoni për kapacitetet tona dhe çka nevojitet që Kosova të mund t'i absorbojë në masë sa më të madhe këto fonde, në mënyrë që të ngrihet niveli ekonomik i vendit.

Lidhur me OBT-në, tha se në Raportin e Progresit për Kosovën, për vitin 2015, është potencuar se Kosova ka pak nivel të përgatitjes në industri për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe pak progres është shënuar në këtë fushë. Ju e shpjeguat çështjen e anëtarësimit në OBT, a keni të shtoni më tepër lidhur me këtë?

Në vazhdim, pyeti: A a i keni identifikuar shtetet me qëndrim neutral, sa i përket mbështetjes për anëtarësim në OBT dhe a keni ndërmarrë ndonjë aktivitet lobues?

Ministrja, tha se me MSA-në, disa produkte janë të mbrojtura për 5, 7 dhe 10 vite, që nënkupton se jo të gjitha produktet, e sidomos ato që prodhohen në Kosovë, nuk është që nga dita e parë e MSA-së, që pritet të implementohet nga 1 prilli, të lirohen të gjitha produktet kosovare, por një numër i vogël i tyre. Kemi kuota, të cilat janë të favorshme në tregun e BE-së, p.sh të kuota e verës, ne kemi 5 mil në krahasim me 2mil litra, që i kemi pasur herën e kaluar. Është mirë e dizajnuar, sepse mbrojtja për 5,7 dhe 10 vite, krijon një hapësirë të mjaftueshme kohore që ndërmarrjet tona të përgatiten dhe të mbrohen. Sa i përket kapaciteteve administrative në MTI, nuk ka kapacitete të mjaftueshme, por nuk mund të themi se nuk jemi të kënaqur, sepse donatorët kanë luajtur një rol të rëndësishëm brenda ministrisë. Ne kemi projekte të vazhdueshme, që stafi trajnohet brenda dhe jashtë vendit. Stafi ka filluar të përgatitet qysh në negocimin e MSA- së. Kurse, sa i përket kapaciteteve të absorbimit të fondeve të IPA-së, kemi ngecur në këtë drejtim dhe jemi mbrapa me implementim të fondeve, dhe në bashkëpunim me Ministrinë për Integritet Evropian, kemi përgatitur të gjitha projektet-afishet.

Jemi duke implementuar aktin për biznes të vogël dhe kemi programe të monitorimit, për të parë se a implementohet edhe programi për reforma ekonomike, e dimë se MSA-ja është nënshkruar me kusht që Qeveria të ndërmarrë një sërë reformash dhe të gjitha këto i kemi pjesë të programit qeveritar 2015-2018. Sa i përket lobimit, shtetet anëtare që i kemi takuar, nuk janë të pakta dhe sugjerimi i tyre ka qenë që duhet të merrni mbështetjen e aktorëve të mëdhenj, siç janë SHBA dhe BE-ja.

Vjosa Osmani diskutoi për 3 çështje:

1. Çështja e mbrojtjes së konsumatorit. Sa i përket mbrojtjes së konsumatorit infrastruktura ligjore, qofshin ligjet, rregulloret dhe direktivat, të cilat janë në fuqi, janë duke u përgatitur me standarde më të mira evropiane, por problemet në praktikë janë jashtëzakonisht të mëdha, ndërsa arsyeja është se në baza ditore, çdo ditë dëgjojmë për shkelje të mëdha që i bëhen të drejtës së konsumatorit, sidomos në të drejtën e ushqimit. Ne çdo ditë shohim ushqime në raftet e marketeve, me afat të skaduar, që rrezikojnë jetën e qytetarëve dhe kjo nuk po tejkalohet si problem. Qytetarët po vetëdijesohen dhe e di se edhe ju keni programe vetëdijesimi, dhe po ashtu, jam pjesë e disa grupeve që po provojmë, që të kemi sa më shumë qytetarë që të adresojnë ankesa. Çka po ndodh me këto ankesa? Nuk e di se sa keni bërë që edhe inspektorët ta respektojnë ligjin.

Flitet shumë që inspektorë të caktuar, merren vesh me biznese të caktuara, që mos t'i pengojnë ata në shitjen e produkteve me afat të skaduar. Pra, sa po punohet në këtë drejtim, që të luftohen këto dukuri, para se të shohim raste fatale, që mund të ndodhin shumë lehtë?

2. Çështja e dytë, ka të bëjë me marrëdhëniet me jashtë, po ashtu me Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT). Dihet mirë se nëse aplikojmë për anëtar vëzhgues, nuk do të jemi të vetmit, sepse 21 shtete tjera, që janë anëtare të OKB-së, kanë statusin e vëzhguesit, sepse është e domosdoshme që 5 vite, së paku para aplikimit për anëtar me të drejta të barabarta, të jenë aty.

Ku jemi tani saktësisht, në aspektin e numrave dhe në aspektin kohor, kur pritni që të bëhet aplikimi dhe a pritni që të bëhet gjatë mandatit tuaj?

A i shihni problemet me 5 shtetet që nuk na kanë njohur apo shihni probleme si me UNESCO-n, ku edhe shtetet që na kanë njohur, tani rezistojnë që të mbështesin një akt të fuqizimit të shtetësisë së Kosovës, që është anëtarësimi në organizata ndërkombëtare.

Çështja e tretë, ka të bëjë me ndryshimin e ligjeve. Ju i keni përmendur një sërë ligjesh, që tani janë në proces të ndryshimit, por shumë prej tyre ne i kemi ndryshuar vitin e kaluar, shembulli është me Ligjin për metrologjinë, që çdo vit vjen për ndryshim, dhe kur vijnë për t'u ndryshuar, vijnë me procedurë të përshpejtuar, që nënkupton se po ikin detaje shumë të rëndësishme. Ka ligje të tjera të rëndësishme, që nëse ndryshohen shpesh, krijojnë pasoja, një prej tyre është Ligji për shoqëri tregtare, i cili është hartuar dhe ndryshuar në mandatin e kaluar dhe ju keni qenë deputete. E di sesa e vështirë është për gjyqtarët, të cilët e aplikojnë këtë ligj që të trajnohen me rregulla të reja, dhe ende pa u trajnuar në këtë fushë, ligjet po ndryshohen përsëri. Andaj, ju lus që t'i keni këto parasysh, sepse ata që i aplikojnë ligjet në praktikë, e kanë të vështirë. Ne si Kuvend, mos të biem para aktit të kryer, me procedura të shpejtuara.

Ministrja, tha se është e vërtetë ajo që u tha për mbrojtjen e konsumatorit. Është rritur numri i ankesave prej konsumatorëve, por nuk mund të përgjigjem se a është rritur numri i produkteve jocilësore në treg apo është rritur vetëdija e konsumatorëve. Besoj se ndëshkimi më i madh i operatorëve ekonomikë të pandershëm, të cilët shesin edhe produkte me afat të skaduar, është pikërisht ndëshkimi që vjen nga ana e konsumatorëve.

Ne kemi gjobat, të cilat Inspektorati ynë i shqipton, por humbim kohë të gjatë nëpër gjykata, ku inspektorët tanë duhet të shkojnë dhe t'i mbrojnë gjobat e tyre. Sa i përket Inspektoratit të MTI-së, ne e kontrollojmë tregun e karburanteve, produktet e sigurisë, por për cilësinë dhe afatet e produkteve ushqimore është Agjencia e Veterinës dhe Ushqimit (AVUK).

Ne kemi Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorit, mirëpo jo të gjitha ankesat janë në mandatin e ministrisë, për t'i zgjidhur ato. Pra, ankesat për cilësinë dhe afatin e produkteve, nga departamenti ynë përcillen në formë të shkruar në (AVUK) dhe merret përgjigja sesa janë zgjedhur këto ankesa. Kurse, në draft-ligjin që e kemi sjellë për karburante, ne i kemi dhënë të drejtë MTI-së, që të publikojë të gjeturat e Inspektoratit, çka nënkupton se ne mos të presim nga gjykatat për produktet e caktuara, por t'ju tregojmë konsumatorëve, se cilët janë operatorët e përgjithshëm e cilët jo. Ne kemi menduar që edhe në fushat e produkteve tjera, jemi duke kërkuar se a e kemi një të drejtë të tillë, që të bëjmë publikimin e të gjeturave të Inspektoratit.

Sa i përket OBT-së, tha se ne kemi lobuar dhe nuk mund të them për numrin e saktë, por në të gjitha takimet që i kemi pasur, kemi marrë mbështetje dhe sugjerimi i të gjithë anëtarëve ka qenë se duhet shkuar si anëtar vëzhgues dhe ta marrim mbështetjen e SHBA-ve, Gjermanisë dhe BE-së. Jemi duke punuar në atë drejtim dhe vetë Kryeministri është i angazhuar dhe mendojmë se aplikacioni duhet të dorëzohet gjatë këtij mandati.

Sa i përket plotësim-ndryshimit të ligjeve është një nga shqetësimet e mia që e kam ngritur në ministri, që nga dita e parë. Është e vërtetë që Ligji për metrologji, është ndryshuar dhe plotësuar, disa herë, për shkak të transpozimit të direktivave. Ne po punojmë në atë drejtim, që këto ligje mos t'i ndryshojmë shumë shpesh, sepse nuk është problem vetëm për gjykatat, por edhe për operatorët ekonomikë, duke pasur parasysh se plotësim-ndryshimet e ligjit po na vijnë me dokumente të ndara dhe asnjëherë nuk po arrijmë të bëjmë fuzionimin e ligjit, në një dokument të vetëm.

Bislim Zogaj, parashtroi disa pyetje.

1. Ai tha se Raporti i Progresit ka konstatuar se ndërhyrja e shtetit në ekonomi mbetet ende e lartë, nuk ka pas progres sa i përket kapaciteteve industriale, për ta kontrolluar ndihmën shtetërore. Po ashtu, tha se ka pasur vërejtje tek autoriteti i konkurrencës, sepse bordi ende nuk ekziston, andaj ju si ministri, a keni ndërmarrë diçka, që sa më shpejt të formohet ky bord, kur

dihet se konkurrenca është një ndër faktorët kryesor, që ndikon në të mirën e konsumatorit, sa i përket konkurrencës.

2. Sa i përket regjistrimit të bizneseve, ju ministre gjatë raportimit thatë se ende janë disa kritere të shumta që po e pengojnë regjistrimin e bizneseve, për dallim nga më parë, po vijnë gjithnjë duke u thjeshtuar, por megjithatë ende ekzistojnë disa pengesa për regjistrimin e tyre. Sa përcillen nga ministria juaj ato biznese kur të regjistrohen në implementimin e projekteve, e sidomos te investitorët e jashtëm?

3. Gjatë raportimit tuaj, nuk e di se a e kuptova mirë, por ju ministre thatë se vizitat e inspektorëve në terren duhet të zvogëlohen, por për mbrojtjen e konsumatorit, mendoj se është me rëndësi që të rriten vizitat e inspektorëve në teren, në inspektimin dhe kontrollimin e bizneseve, sepse sado që janë ligjet e mira, ato po vonojnë në implementim.

4. Në vazhdim, tha se kamatat janë të larta në bankat komerciale, dhe shtoi se ju si ministri, do të kishte qenë mirë të bëni më shumë në zvogëlimin e kamatave, sepse risku është i madh tek kreditë dhe kolaterali nuk është i mjaftueshëm për kredi, për të investuar në industri. Andaj, pyetja ime është: a do të kishte mundësi që të ketë gjykatë ekonomike për azhurnimin e lëndëve në rastet te bankat kur nuk kthehen kreditë dhe ministria të intervenojë që me donacione të ndryshme apo përmes bankave që janë për zhvillim, të intervenojë, që t'i mbështesin ato biznese që janë n; fillim?

Ministrja, lidhur me ndihmën shtetërore, tha se e kam lexuar Raportin e Progresit, por nuk më kujtohet saktësisht se ku shkruhet që kemi një ndërhyrje të madhe të shtetit në ekonomi, por mendoj se nuk ka ndërhyrje të madhe të shtetit. Ekonomia e tregut është e lirë dhe operatorët e biznesit zgjedhin se ku do ta investojnë kapitalin e tyre.

Kurse, sa i përket Autoritetit të Konkurrencës, me plotësim- ndryshimin që i është bërë ligjit, kjo kompetencë ka kaluar në Zyrën e biznesit. Ne kemi kaluar vendimin në Qeveri dhe ka ardhur propozimi që në seancën e radhës të votohet Autoriteti i Konkurrencës, që i raporton Kuvendit. Në kuadër të Ministrisë së Financave, jam pjesë e grupit punues në draftimin e Projektligjit për ndihmën shtetërore dhe jemi duke hulumtuar me legjislacionin e rajonit, sepse është pak e vështirë të definohet se ku duhet të lejohet e ku jo. Kurse, sa i përket regjistrimit të bizneseve, tha se mund të kryhet brenda 24 orëve në MTI dhe po shkurtojmë procedurat, duke bërë unifikimin e numrave dhe duke mos pasur nevojë operatorët ekonomikë të regjistrohen edhe një herë në doganë dhe në ATK. Me Ligjin për investitorët e huaj, investitorët e jashtëm trajtohen njëjtë, sikurse investitorët e brendshëm.

Sa i përket reformës së inspektimeve, ne tani kemi shumë trupa inspektuese. Më herët u përmend rasti i produkteve me afat të skaduar. Sipas legjislacionit në fuqi, inspektorët e MTI-së mund të kontrollojnë se a janë çmimet e njëjta në arkë, por për produktet me afat të skaduar, ata nuk kanë të drejtë të shqiptojnë gjoba, por ata duhet ta njoftojnë Inspektoratin e AVUK-ut, që ta të vijnë e t'i ndëshkojnë, kurse inspektorët doganorë dhe të tatimit, kanë kompetenca tjera.

Sa i përket kamatave, u përmend ndërhyrja e shtetit, do të ishte ndërhyrje flagrante e shtetit, nëse shteti do t'ju tregoj bankave komerciale për vendosjen e kamatave të tyre. Jemi ekonomi e tregut dhe nuk kemi monopol. Atë çka jemi duke e bërë, është Fondi për Garanci Kreditore, i cili do të mbulojë 50% të riskut, edhe pse qëllimi i këtij fondi, nuk është për të ulur kamatën, por në këtë formë, në formë të drejtpërdrejtë, do të ndikojë.

Me ndryshim-plotësimin e ligjeve për gjykatat, që janë bërë vitin e kaluar, në kuadër të gjykatës, është formuar një departament për kontestet biznesore dhe tani kemi edhe përmbaruesit privatë dhe lëndët e bankave nuk po iu marrin shumë kohë dhe po përfundojnë.

Ne, gjithashtu, në kuadër të Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik, e kemi grupin punues i cili kryesohet nga Ministria e Drejtësisë dhe i adreson këto çështje. Kamatat janë ulur kohën e fundit dhe presim të ulen me Fondin për Garanci Kreditore.

Luljeta Gutaj Veselaj, pyeti ministren: Gjatë kohës suaj të lobimit nëpër vendet e ndryshme anëtare dhe ato që nuk e kanë njohur Kosovën, a keni arritur që gjatë lobimit tuaj të lidhni marrëveshje konkrete për investime industriale në Kosovë, me ndonjë investitor që është i gatshëm të bëjë marrëveshje me ministrinë tuaj dhe të investojë? Në vazhdim, tha se shqetësim për te gjithë ne është se çdoherë në marketet tona po hasim ushqim me afat te skaduar.

Ministrja, sa i përket investimeve të huaja, tha se kemi pasur një rritje të madhe të investimeve të huaja dhe në vitin 2015, ka qenë trendi më i madh i rritjes dhe kemi arritur që tregun negativ ta shndërrojmë me shumë pozitivizëm. Në takimet që kemi pasur jashtë shtetit, me odat ekonomike në Gjermani dhe Austri dhe shtetet tjera, ne kemi bërë një prezantim të gjendjes dhe ambientit për investime në Kosovë, dhe si rezultat i kësaj, kanë ardhur iniciativa private, të cilat nuk kanë pasur nevojë marrëveshjeje me MTI-në.

Vjosa Osmani, pyeti: A keni diskutuar me Ministrinë e Drejtësisë për krijimin e infrastrukturës ligjore, që mund të rrisë gjobat për bizneset që nuk i respektojnë rregullat e çmimeve dhe shesin ushqime me afat të skaduar? Kjo në aspektin afatgjatë ka efekt shumë pozitiv për bizneset, sepse ngrit besimin tek qytetarët. Në vendet e zhvilluara, nëse një konsumatori i cenohet shëndeti, pas konsumimit me afat te skaduar, mund të marrë shumë të madhe të parave, si dëmshpërblim në gjykatat e tyre. Procedurat në gjykatat tona, janë të gjata dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, mund të analizohen nëpërmes rregullatorit ligjor dhe pastaj zbatimit të tyre.

Ministrja theksoi se ne nuk kemi biseduar për këtë çështje me Ministrinë e Drejtësisë, por ne kemi grupin punues, në kuadër të Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik, ku më tepër adresohen barrierat që i kanë bizneset, por mund ta diskutojmë një masë të tillë. Të gjitha llojet e gjobave janë të përcaktuara jo me një ligj të përgjithshëm, por me ligje respektive, që janë në kompetenca dhe mandate të institucioneve të ndryshme.

Në vazhdim, ia dha fjalën z. **Rexhep Bllaca**, drejtor i Departamentit Ligjor në MTI. Ai tha se sa i përket çështjes së mbrojtjes së konsumatorëve, ne jemi në kontakt me inspektoratet dhe autoritet gjyqësore, që duke pasur parasysh rrezikun e madh të produkteve ushqimore, që të gjitha shkeljet mos të trajtohen si individuale, por të trajtohen si fenomen dhe proces.

Arben Gashi, lidhur me rritjen e investimeve të jashtme në vitin 2015, prej 378 mil, pyeti ministren: Në cilët sektorë janë bërë ato investime të jashtme?

Ministrja, tha se shumica e investimeve janë bërë në sektorin e ndërtimtarisë dhe patundshmërive. Sa i përket strukturës së investimeve të huaja direkt, kjo lë për të dëshiruar, sepse më tepër është blerje e patundshmërive, mirëpo vlen të vlerësohet si trend pozitiv dhe shpresë e kthimit te investitorëve.

Arben Gashi, u ndërlidh në diskutim dhe pyeti: A konsiderohen investime të jashtme blerja e banesave nga bashkatdhetarët tanë dhe a janë konsiderua si investime të jashtme edhe investimet që i kanë bërë bankat komerciale në Kosovë, duke mos e çuar profitin jashtë, por duke investuar në Kosovë?

Ministrja, theksoi se blerja e patundshmërive nga diaspora konsiderohet si investim, sepse ai kesh hyn në Kosovë në sektorin e ndërtimtarisë dhe krijon efekte multifikuese, sepse kompanitë e ndërtimit ndërtojnë prapë. Kurse, sa i përket asaj se a konsiderohet si i investim i huaj mbajtja e fitimit nga ana e bankave komerciale që kanë shumicën e aksionarëve të huaj, sigurisht që banka e regjistruar në Kosovë, nuk mund të konsiderohet si kompani e jashtme, por varet pastaj përqindja e aksioneve dhe e dividendës së mbajtur dhe ajo nuk mund të jetë vetëm fitim i mbajtur, por ajo duhet te investohet nëpër asete, që të mund të konsiderohet si i tillë.

Kryetarja falënderoi ministren për raportimin e detajuar, lidhur me planet e MTI-së për zbatimin e MSA-së.

Shqyrtimi i Raportit të grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-140 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale

Kryetarja, lidhur me këtë pikë, ia dha fjalën kryesuesit të grupit punues.

Ilir Deda, tha se Ligji 04/L-140 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale, është monitoruar edhe në mandatin e kaluar, për shkak të zgjedhjeve nuk ka mundur të përfundojë raportin. Gjatë periudhës 6 mujore, grupi punues është takuar me prokurorinë, gjyqësinë, policinë dhe mekanizma tjerë të sistemit të drejtësisë dhe sundimin e ligjit. Më së shumti jemi fokusuar në atë se cilat janë mekanizmat që nuk funksionojnë në zbatimin e suksesshëm të ligjit. Jemi konsultuar edhe me shoqërinë civile, përkatësisht me Grupin për Studime Juridike dhe Politike dhe Institutin KIPRED, që janë marrë më së shumti me këtë fushë të legjislacionit dhe të cilët japin kontribut edhe në punën e komisioneve të ndryshme.

Si përfundim, janë 13 rekomandime që janë nxjerrë në bazë të diskutimeve, që kemi pasur me institucionet përgjegjëse dhe pjesëtarët e shoqërisë civile.

Kryetarja, tha se e kam lexuar me vëmendje raportin dhe pyeti lidhur me rekomandimin e parë, paqartësia është tek fjalia e dytë „Alternativë ndaj këtij opsioni do të ishte kalimi i një ligji të veçantë që rregullon hetimin e pasurisë së paligjshme, me barrën e provës të vendosur në palën e dyshuar” dhe te rekomandimi i pestë, ku e keni shtuar administratën tatimore dhe Policinë e Kosovës. A do të thotë se administrata tatimore dhe doganat, vetvetiu mund të ngrenë hetime, na tregoni si e keni menduar këtë ,a ia jep kjo fuqinë administratës tatimore?

Ilir Deda, theksoi se Kjo nuk ia jap fuqinë administratës tatimore, por vetëm është koordinues më i mirë ndërmjet institucioneve, të cilat janë përgjegjëse dhe të gjitha kanë përgjegjësi, si dhe nuk kanë shkëmbim të mirë të informatave njëra me tjetrën. Ndërsa, për pikën e parë, tha se BE-ja nga Kosova ka kërkuar një kohë të gjatë ta bëjë Ligjin antimafia. Tek ne këtu, ka pasur rezistencë dhe udhëzimet që i kemi bërë, janë kriteri i vendosur nga BE, dhe nëse dilet nga kornizat, nuk e pranojnë ligjin dhe nuk kemi bërë asgjë.

Bislim Zogaj, tha se duhet të mendohet edhe për individin apo biznesin, nëse nuk është fajtor ose padrejtësisht iu ka konfiskuar pasuria.

Ilir Deda, kjo nuk ka të bëjë me palën e dëmtuar dhe mosmbrojtjen dhe termi i ri juridik, barra e provës, duhet të përdoret edhe tek ne, te ndarja e përgjegjësisë, sepse është marrë nga praktikat më të mira.

Arben Gashi, sqaroi lidhur me barrën e provës dhe tha se barra e provës, në rastin konkret të ligjit në fjalë, barra e provës bie mbi të akuzuarin, sepse për këto vepra penale, që parashihen me këtë ligj, bien mbi të akuzuarin dhe ai duhet të dëshmojë se është i pafajshëm.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Rekomandim

Miratohet Raporti i grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-140 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale dhe procedohet në seancë plenare .

Të ndryshme

Kryetarja njoftoi për formimin e komisionit të përbashkët parlamentar për MSA-në dhe njoftoi për përbërjen e tij.

Vjosa Osmani, kundërshtoi përbërjen e këtij komisioni dhe tha se kemi biseduar më herët lidhur me këtë dhe rekomandimi i nxjerrë është bërë pjesë e ligjit për Kuvendin dhe ka marrë parasysh shumë praktika, si dhe është diskutuar edhe me znj. Ulrike Lunacek, e cila ka propozuar pikërisht që në Komisionin e përbashkët parlamentar, të përfshihet komplet Komisioni për Integritet Evropian dhe anëtarë të komisioneve tjera specifike, që bien mbi domenin e MSA-së, por fatkeqësisht, vendimi i Kryesisë në përbërjen e këtij komisioni, ku janë përfshirë anëtarët e Kryesisë dhe shefat e grupeve parlamentare, është në kundërshtim të plotë me rekomandimet që ne i kemi dhënë, duke u bazuar në njohuritë dhe përvojën që e kemi, për vite të tëra në këtë fushë dhe e injoron rëndësinë e procesit të integritetit evropian për Kosovën. Prandaj, si deputete e këtij komisioni, tha se e kundërshtoj fuqishëm përbërjen e këtij komisioni dhe mendoj se është fyerje ndaj Kuvendit, si institucion dhe përpjekjet e popullit të Kosovës, që po i bën vazhdimisht në këtë proces. Në fund, propozoi që Komisioni për Integritet Evropian, ta kundërshtojë në mënyrë konkrete këtë përbërje dhe me shkrim t'ja dërgojë Kryetarit të Kuvendit, që të injorohet ai vendim dhe të respektohet ajo që është propozuar, pra që është diskutuar edhe me njerëz të rëndësishëm të Parlamentit Evropian dhe të merret parasysh, komplet Komisioni për Integritet Evropian dhe anëtarë që caktohen nga komisionet.

Ilir Deda, tha se kam qenë i befasuar dhe i zhgënjyer me këtë përbërje, sepse vitin e kaluar, së bashku me Komisionin për Legjislacion, kemi marrë praktikën më të mira dhe kemi vendosur standard institucional, si të merret Kuvendi me MSA-në dhe fushëveprimi ka qenë i caktuar dhe kemi vendosur që Komisioni për Integritet, të jetë komision udhëheqës dhe anëtarët e komisioneve tjera, që janë të involvuara direkt me MSA-në, duhet të përfshihen në komisionin e përbashkët, dhe shkelja që është bërë, është jo-institucionale dhe nuk i merr parasysh praktikën e asnjë vendi tjetër dhe nuk tregon seriozitet institucional të Kuvendit të Republikës së Kosovës, karshi MSA-së. Ne, si Komision, duhet të kërkojmë takim me Kryetarin e Kuvendit dhe t'ia sqarojmë se vendimi i marrë na çon mbrapa dhe e dëshmon jo-seriozitetin.

Kryetarja, sa për informim, tha se nga janari kam kërkuar takim me Kryetarin e Kuvendit, por takimin nuk kam arritur asnjëherë ta bëjë, për shkak të angazhimeve të Kryetarit, dhe nëpërmjet të tjerëve, e kam informuar se Komisioni për Integritet Evropian, në amendamentin e propozuar në Ligjin për Kuvendin, ka propozuar edhe përbërjen e Komisionit të përbashkët parlamentar.

Arben Gashi, konsideroi se në aspektin procedural, është bërë gabim nga Kryesia e Kuvendit, sepse në bazë të Rregullores së Kuvendit, Kryesia nuk mund të vendosë për anëtarë të komisioneve, sepse për anëtarët e komisioneve vendoset në seancë.

Kryetarja, pasi nuk kishte diskutues tjerë lidhur me këtë pikë, e mbylli mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në orën 12:50.

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Teuta Sahatqija